


## Ndryshimet në legjislacion

Dhjetor 2016

### Në këtë publikim:

- Ligji Nr. 05/L-101 Për Performancën Energjetike në ndërtesa;
- Ligji Nr. 05/L-124 Për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2016 Për Përcaktimin e procedurave për regjistrimin e pengut, taksave dhe shërbimeve tjera;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2016 Për plotësim ndryshimin e udhëzimit administrativ nr. 03/2015 Për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar;
- Rregullore për Qeverisjen Korporative të Bankave;
- Rregullore për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve;
- Rregullore për investimin e asetëve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar te siguruesve;



### I. Ligji Nr. 05/L-101 Për Performancën Energjetike në ndërtesa

Ligji për performancën energjetike në ndërtesa është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 22 dhjetor 2016, dhe do të hyj në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ky Ligj ka për qëllim të promovojë përmirësimin e performancës energjetike në ndërtesa, duke marrë parasysh kushtet e jashtme dhe lokale klimatike, si dhe kërkesat për klimën e brendshme dhe koston efektive.

Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën nr.2010/31 të BE-së për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe Direktivën 2012/27/të BE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për efikasitetin e energjisë.

Ky Ligj përcakton kërkesat për:

- kornizën e përgjithshme për metodologjinë kombëtare për llogaritjen e performancës së integruar energjetike të ndërtesave dhe njësisve të tyre;
- kërkesat minimale për performancën energjetike për: ndërtimin e ndërtesave të reja; dhe ndërtesat ekzistuese dhe njësisve të tyre që i nënshtrohen rinovimeve të mëdha.
- kërkesat e përgjithshme për sistemet teknike në ndërtesat ekzistuese;
- planet kombëtare për rritjen e numrit të ndërtesave me konsum afërsisht zeroenergji duke përfshirë shqyrtimin e stimujve financiarë dhe barrierave të tregut për të nxitur kalimin tek ndërtesat me konsum afërsisht zero-energji;

- certifikimin energjetik të ndërtesave dhe njësisive të ndërtesave dhe përmbajtja, lëshimi dhe ekspozimin e certifikatës;
- inspektimi i rregullt i sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit duke përfshirë formën dhe përmbajtjen e raporteve të inspektimit apo masave alternative me efektivitet të njëjtë;
- licencimi i ekspertëve të pavarur dhe krijimi i një sistemi të pavarur kontrolli për certifikatat e performancës energjetike të ndërtesave;
- krijimi i një sistemi të raportimit për raportet e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit.

Brenda 18 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji institucionet përgjegjëse dhe kompetente nxjerrin aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

## **II. Ligji Nr. 05/L-124 Për Ratifikimin e marrveshjes financiare për IPA 2015<sup>1</sup> ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian;**

Ligji për ratifikimin e marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 15 dhjetor 2016.

Qëllimi i këtij ligji është ratifikimi i Marrëveshjes financiare për IPA 2015 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Marrëveshja financiare për IPA 2015 (tani e tutje "Programi") ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, konsiderohet e ratifikuar me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Përmes kësaj marrëveshje financiare Bashkimi Evropian, tani e tutje i referuar si "Unioni" pajtohet të financoj dhe Kosova si përfituesi i këtij programi pajtohet të pranoj financimin si në vijim:

Kostoja totale e vlerësuar e këtij Programi është EUR 81 000 000 dhe kontributi maksimal i Unionit për këtë Program është EUR 78 000 000.

Ky program kërkon kontribute financiare edhe nga përfituesi i IPA II edhe nga BE. Ndarja e kontributeve financiare përkatëse është e përcaktuar në Shtojcën I.

Shtojca 2 e kësaj Marrëveshje financiare përcakton dhe periudhën e ekzekutimit të saj, që është caktuar për një afat 12 vjeçar, nga koha e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje të Financimit.

Kohëzgjatja e periudhës së zbatimit operacional të kësaj Marrëveshjeje të Financimit siç parashihet në Nenin 12 të shtojcës 2 është caktuar për një afat 6 vjeçar, nga koha e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje të Financimit.

Ky ligj për ratifikimin e marrëveshjes financiare IPA 2015 hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës

## **III. Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2016 Për Përcaktimin e procedurave për regjistrimin e pengut, taksave dhe shërbimeve tjera;**

Më 7 nëntor 2016, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka lëshuar Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2016 Për Përcaktimin e procedurave për regjistrimin e pengut, taksave dhe shërbimeve tjera.

Baza ligjore e këtij udhëzimi administrativ është ligji Nr. 04/L-136 Për regjistrimin e pengut në regjistër për sendet e luajtshme.

Ky udhëzim Administrativ përcakton procedurën e regjistrimit të pengut, lartësinë e taksave, dhe mënyrën e pagesës të të gjithave shërbimeve të ofruara nga Sektori i Pengut.

Ky udhëzim administrative gjithashtu rregullon çështjet tjera që mund të lindin nga regjistrimi i pengjeve në sistemin e pengut. Këtu rregullohen edhe procedurat për kërkesat për regjistrim dhe ndryshim të regjistrimeve. Përgjegjësia e regjistrimit të pengjeve, vërtetimi i informacioneve, kërkesat e paraqitura nga përdoruesit e llogarive janë gjithashtu pjesë e këtij udhëzimi administrativ.

Në krahasim me udhëzimin administrative paraparak, ky udhëzim administrative parasheh dhe shërbimet e Veçanta që përfshijnë shërbimin e regjistrimit në grumbull dhe shërbimin arkiva ime.

<sup>1</sup> Instrument i Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA-II)

Regjistrimi në grumbull i lejon përdoruesit të bëjë regjistrimin e një grupi të draft regjistrimeve në regjistrin e pengut, ndërsa shërbimi Arkiva ime i lejon përdoruesit ti qasen certifikatave të tyre të lëshuara nga Regjistri i Pengut.

Me këtë udhëzim administrativ taksat e regjistrimit janë zvogëluar, si në vijim:

- Taksa mujore për çdo llogari nga 1€ në 0€;
- Taksa bazë e regjistrimit nga 3€ në 2€;
- Taksa për ndryshime në regjistrim nga 3€ në 0.50€;
- Taksa për shlyerjen e mallrave me numër serik nga 0.50€ në 0.30€.

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ shfuqizohet udhëzimi administrativ Nr. 09/2013.

#### **IV. Udhëzimi Administrativ Nr. 06/2016 Për plotësim ndryshimin e udhëzimit administrativ nr. 03/2015 Për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar**

Më 5 dhjetor 2016, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës ka lëshuar Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2016 Për plotësim ndryshimin e udhëzimit administrativ nr. 03/2015 Për zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi vlerën e shtuar.

Ky Udhëzim Administrativ përcakton rregullat dhe procedurat për zbatimin e TVSH-së sipas dispozitave ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës dhe për të gjithë personat e tatueshëm që janë përcaktuar në fushëveprimin e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit.

#### **V. Rregullore për Qeverisjen Korporative të Bankave**

Më datë 29 dhjetor 2016, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) miratoi Rregulloren për Qeverisjen Korporative

të Bankave, kjo rregullore do të hyjë në fuqi me datë 1 mars 2017.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të fuqizojë kornizën rregullative lidhur me praktikën e mira të qeverisjes korporative të bankave, si faktor i rëndësishëm për ruajtjen e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sektorit bankar në tërësi.

Në bazë të kësaj rregulloreje qeverisja korporative nënkupton mënyrën e menaxhimit të aktiviteteve gjithëpërfshirëse të sektorit bankar, ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësisë nga aksionarët e tyre, bordet e drejtorëve dhe menaxhmenti i lartë. Gjithashtu me qeverisjen korporative do të përfshiheshin edhe hartimi i strategjisë bankare, objektivat korporative, mbikëqyrja e personelit, pajtueshmëria e veprimtarisë bankare dhe sjelljet korporative me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.

Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për aksionarët e bankave, Bordin e Drejtorëve dhe Menaxherët e Lartë lidhur me përgjegjësitë e tyre në qeverisjen korporative.

Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat që veprojnë në Republikën e Kosovës, të licencuara nga BQK-ja.

Degët e bankave të huaja duhet të njoftojnë BQK-në nëse hasin në konflikte në mes të zbatimit të kësaj rregulloreje dhe ligjeve dhe rregulloreve të cilat i zbatojnë në juridiksionin e vendit amë. Përveç nëse lirohen në mënyrë eksplicite nga BQK-ja me anë të ndonjë rregullore apo akt tjetër juridik, ato detyrohen të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore për operacionet e tyre në Kosovë

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-bankare.

#### **VI. Rregullore për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve**

Më datë 29 dhjetor 2016, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) miratoi Rregulloren për Shitjen e Sigurimit të Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia dhe Menaxhimin e Shpenzimeve të Siguruesve të Bankave. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi me datë 4 janar 2017.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve dhe mënyrës së shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia, dhe kufizimeve të shpenzimeve të menaxhimit të Siguruesve.

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë Siguruesit e licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Sipas kësaj rregullore, komisioni për ndërmjetësuesit në sigurime sa i përket produktit të sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia mund të aplikohet nga Siguruesit deri në maksimum 10% të shitjes së tij (përfshirë të gjitha shpenzimet tjera). Në çdo rast, komisionet dhe shpenzimet e pikave të shitjes të sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia nuk duhet të kaloj 12% të primit të paguar pas zbritjes së TVSH-së.

Kjo rregullore obligon Siguruesit që të mbajnë vetëm një llogari bankare, në të cilën do të grumbullojnë mjetet e arkëtuara nga shitja e sigurimit të detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

Siguruesit janë të obliguar që të dorëzojnë në mënyrë elektronike në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në baza mujore, deri me datën 5 të muajit vijues, disa informata përfshirë, por jo kufizuar në:

- a. Llogarinë bankare të shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për muajin paraprak;
- b. Raportin e detajuar te pageses se demeve nga llogaria bankare e shitjes se sigurimit te detyruesheml;
- c. Raportin e detajuar të shitjes së sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, me llogaritjen e komisionit dhe shpenzimeve të përcaktuara me këtë rregullore.

Kjo rregullore gjithashtu rregullon menaxhimin e shpenzimeve të përgjithshme dhe parapagimeve ku, përpos tjerash, specifikohet edhe shuma maksimale e shpenzimeve të përgjithshme në para të gatshme nga të gjitha klasat e sigurimeve.

Parashihet që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka të drejtë që të shqiptoj masa administrative ndaj siguruesve të cilët nuk e zbatojnë në përpikëri këtë rregullore.

## **VII. Rregullore për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar te siguruesve**

Më datë 29 dhjetor 2016, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) miratoi Rregulloren për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar te siguruesve. Kjo rregullore do te hyj ne fuqi me datë 31 dhjetor 2016.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i kategorive të investimeve të aseteve në mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike, kufijve maksimale të lejueshme të investimeve lidhur me këto asete, si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve.

Kjo rregullore aplikohet për të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm që ushtrojnë aktivitetet në Kosovë që janë të licencuar, rregullohen dhe mbikëqyren nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Sipas kësaj rregullore, Siguruesit kanë për detyrë të mbajnë asete të mjaftueshme në mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike jo më pak se vlera bruto e provizioneve teknike. Këto asete që mbahen në emër të mbulimit të provizioneve teknike dhe matematike nuk mund të tërhiqen, investohen, tjetërsohen apo të lihen kolateral, përveç kur një ndalesë e tillë përjashtohet specifikisht nga kjo rregullore.

Investimi i aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike nga siguruesit duhet të plotësojnë këto kushte:

- a. Asetet e investuara duhet të jenë mjaftueshëm të sigurta;
- b. Asetet duhet të jenë të investuara në atë formë që të jenë në gjendje të shlyejnë detyrimet ndaj të siguruarve në çdo kohë;
- c. Asetet duhet të mbahen në atë formë që të jenë të disponueshme në çdo kohë;
- d. Asetet e investuara duhet të jenë mjaftueshëm të diversifikuara.

Kategoritë e aseteve përfshirë, por jo kufizuar në, këto më poshtë mund të përdoren për mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike:

- a. Depozita në valutë Euro në banka të licencuara në Kosovë;
- b. Bono thesari, obligacione dhe instrumente tjera financiare të tregut të kapitalit, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;

Kjo rregullore gjithashtu përcakton asetet të cilat nuk mund të bëjnë mbulimin e provizioneve teknike dhe matematike ku përfshihen, por nuk kufizohen, në:

- a. Asetet të cilat shërbejnë për financimin e kapitalit të vetë siguruesit apo financimin e kapitalit të ndonjë subjekti tjetër, që është palë e ndërlidhur me siguruesin;
- b. Huatë për brokerat dhe agjentët;

Kjo rregullore përcakton edhe afatet në lidhje me mbajtjen e aseteve në mbulim të provizioneve teknike nga Siguruesit.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore shfuqizohet Rregullorja për Investimin e Aseteve në Mbulim të Provizioneve Teknike dhe Matematike si dhe Investimin e Kapitalit Themeltar të Siguruesve e datës 1 mars 2016.

## Kontaktet e Deloitte:

### **Afrore Rudi**

Drejtoreshë | Shërbime të Taksave dhe Ligjore  
Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Ali Hadri n.n., 10000  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Cel: +386 (0)49 590 807  
E-mail: [arudi@deloittece.com](mailto:arudi@deloittece.com)

### **Luljeta Plakolli - Kasumi**

Menaxhere | Shërbime Ligjore  
Deloitte Kosova sh.p.k.  
Rr. Ali Hadri n.n., 10000  
Prishtinë, Republika e Kosovës  
Cel: +386 (0)49 780 769  
E-mail: [lplakollikasumi@deloittece.com](mailto:lplakollikasumi@deloittece.com)

## **Përrjashtim i përgjegjësisë:**

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të i ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

\*\*\*

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën [www.deloitte.al/about](http://www.deloitte.al/about).

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në saje të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.

© 2017 Deloitte Kosova sh.p.k